



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:001761

Datë: 12.02.2021

Numri i dokumentit: 01503613

P.nr.101/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Arjeta Gashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit R.P.nga Mitrovica, lagjia Zh..., Rr'...' p.n, për shkak të veprës penale, Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) –kodi numër. 06/L-074, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.80-7/2021 të datës 29.01.2021, në seancën publike në prezencën e Prokurorit të shtetit Mehreme Hoxha, të akuzuarit, mbrojtësit të tij, avokat N.M., me datë 02.02.2021 mori dhe shpalli, ndërsa përpiloi me datë 12.02.2021 këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

R.P., nga i ati Xh. dhe e ëma A., e lindur Ibrahimimi, i lindur me datë ..., në fshatin Zh..., Komuna e Mitrovicës, tani me banim në lagjen 'Zh...' Rr.'...', ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit ...

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 06.01.2021, rreth orës 09:59 minuta në Prizren, tek qendra tregëtare '...', i pandehuri R.P. me qëllim që vetës t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, tenton të kryejë vjedhje duke depërtuar në vetura të mbyllura, në atë mënyrë që i pandehuri haset nga punëtori i sigurimit të qendrës tregtare duke u futur në një automjet të markës '...', ngjyrë e hirit me shenje regjistruese ..., pasi që i pandehuri kishte përdorur paraprakisht pajisjen teledirigjuese'...', me shenje regjistruese ..., hynë në automjetin gjegjës ku edhe haset nga ana e punëtorit të sigurimit.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) –kodi numër. 06/L-074.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura dhe nenit 4, 7, 8, 9,10, 17, 38, 39, 40, 46, 69, 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës(KPPRK), të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej tre (3) vite nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. Në rast të revokimit të dënimit me kusht gjatë periudhës së verifikimit, të akuzuarit do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 06.01.2021 deri më 05.02.2021.

Të akuzuarit në kuptim të nenit 115 të KPPRK-së i konfiskohet: një (1) ... (1) t... , si mjete të kryerjes së veprës penale.

I akuzuarit obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë 20 euro në emër të paushallit gjyqësor dhe 30 euro në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.II.nr.80-7/2021 të datës 29.01.2021, kundër të akuzuarit R.P.nga Mitrovica, lagjia Zh..., Rr'...' p.n, për shkak të veprës penale, Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) –kodi numër. 06/L-074.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar në prezencën e palëve. Është lexuar aktakuza nga prokurori i shtetit. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar akuzën dhe e pranojnë fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe provueshmërinë e provave, e ndiejnë veten fajtor, se është penduar dhe i premtton gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale të kësaj natyre.

Prokurori i Shtetit ka konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nuk e ka kundërshtuar të njëjtën, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka gjetur mbështetje në provat të cilat janë siguruar në këtë çështje penale, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari, e cila është në pajtim me nenin 248 të KPPK-së.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Sa i përket gjendjes faktike konsiderohet se ajo është vërtetuar plotësisht si në përshkrimin faktik të aktakuzës nën kushtet dhe rrethanat ligjore të pranimit të fajësisë.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka gjetur se nuk ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimit i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari në këtë shqyrtim ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit që në fazën fillestare, keqardhjen dhe pendimin për rastin e ndodhur, është kryefamiljar- mbajtës i familjes ku jeton vetëm me bashkëshorten dhe një vajzë tre vjeçare dhe se janë në pritje të fëmijës të dytë, i gjendjes së dobët ekonomike është hera e parë që bie ndesh me ligjin. Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese andaj ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuarit dhe se shqiptimi i dënimit të tillë do të ndikojë që i akuzuari të përmbahen nga veprimet kundërligjore.

Vendimi për konfiskim është marrë në kuptim të nenit 115 par.2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2021:001761, 12.02.2021

G j y q t a r j a

Arjeta Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.